



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2019:184109

Datë: 05.04.2024

Numri i dokumentit: 05554475

**C. nr. 1126/21**

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA GLLOGOC** Departamenti i përgjithshëm si gjykatë e shkallës së parë, me gjyqtar Astrit Gashi dhe sekretaren Juridike Fatmire Mehmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditësit **F.H nga Komuna e Glogocit, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit L.D nga Prishtina**, kundër të paditurave KS "S..." me seli në Prishtinë të cilën e përfaqëson sipas autorizimit F.K, dhe "A..." sh.p.k - Prishtinë të cilën e përfaqëson sipas autorizimit B.A nga Prishtina, në kontestin që ka të bëjë lidhur me shpërblimin e dëmit vlera e kontestit 25,000.00 €, në procedurë të rigjyimit dhe rivendosjes, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor me datën 12.03.2024 në prezencën e përfaqësuesve me autorizim të palëve ndërgjygjëse, me datën 04.04.2024 e mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. **APROVOHET PJESËRISHT** si e bazuar kërkesëpadia e paditësit **F.H nga Komuna e Glogocit, dhe DETYROHET** i padituri i parë "K..." me seli në Prishtinë, që për shkak të lëndimit të rëndë në punë të paditësit me datën 04.01.2014 të ia paguaj paditësit F.H në emër të kompensimit të dëmit material për shpenzimet e mjekimit në shumën e siguruar/kontraktuar prej **800,00 €** me kamatë ligjore prej 8 % në vit nga dita e paraqitjes së padisë në gjykatë me datën 12.01.2015 e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 2857,63 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarrimit ligjor.
- II. **REFUZHET** pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit F.H me të cilën ka kërkuar që të **detyrohet** e paditura e dytë "A..." sh.p.k me seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material në bazë të përgjegjësisë primare për shkak të lëndimit të rëndë trupor në punë të paditësit me datën 04.01.2014 të ia paguaj paditësit F.H shumat si në vijim: a). Për dëmin jo material për lëndim të rëndë trupor: në emër të dhimbjeve trupore fizike, shumën prej 10.000,00 €, në emër të frikës së përjetuar shumën prej 7.000,00 €, dhe b). Për dëmin material: në emër të shpenzimeve për mjekim shumën prej 4.200,00 €, dhe në emër të ushqimit të përforcuar, shumën prej 3.000,00 €, e në shumën e përgjithshme prej 24.200 Euro në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarrimit ligjor.
- III. **REFUZHET** si e pabazuar kërkesa e të paditurit të dytë që të detyrohet paditësi që të ia paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 1768,00 Euro.

**A r s y e t i m**

**Historiku i çështjes dhe i Procedurës:**

Paditësi përmes të autorizuarit të tij ka kërkuar nga Gjykata që të aprovet kërkesë padia dhe të detyrohen të paditurat që në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar me rastin e lëndimit në punë paditësit i cili ka pasur lëndime të renda trupore dhe ka qenë i siguar te e paditura KS, „S...” dhe te e paditura e dytë „A...” për lëndimet e pësura është trajtuar në Qendrën Emergjente në QKUK në Prishtinë, gjegjësisht në kliniken Ortopedike dhe Traumatologjisë Lokmoteve ku ka qëndruar nga data 06.01.2014 e deri me dt. 15.01.2014 me çka shihet edhe në fletë lëshimin e kësaj klinike me nr. Të historisë 30, ndërsa lartësia e kërkesëpadisë është provuar në bazë të mendimit të ekspertëve mjekësorë dhe ekspertit të mbrojtjes në punë. Kërkesëpadia është e bazuar në kuptim të dispozitave të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve shpenzimet e procedurës i ka kërkuar sipas listës së specifikuar të shpenzimeve.

Të paditurat në përgjigje në padi e kanë kontestuar padinë të përgjegjësisë për shkaktimin e aksidentit (incidentit) në punë por edhe sa i përket lartësisë së kompensimit të dëmit.

Në seancën e shqyrtimit kryesorë me datën 16.09.2020, i autorizuari i të paditurit të parë ka theksuar se: *siç kam deklaruar edhe në seancat e kaluara ekspertiza është hartuar me aktvendim të Gjykatës megjithatë për të paditurin e parë nuk është me rëndësi fare ekspertiza, për shkak të kontratës të cilën e kemi lidhur me kompaninë „A...” dhe format e kompensimit të dëmit, a është fajtorë punëdhënësi apo punëmarrësi, për të paditurën e parë nuk ka fare rëndësi sepse e mbulojnë palën e dëmtuar vetëm në bazë të kontratës së nënshkruar nga të dy palët.* Ndërsa i autorizuari i paditëses së dytë “A...” ka theksuar se: *e kam pranuar ekspertizën, vërejtjet në ekspertizë, vërejtje në ekspertizë nuk kemi, i kundërshtojmë disa pretendime të palës paditëse në ekspertizë, të cilat konsiderojmë që të sqarohen për gjykatën mirëpo të njëjtat do ti bëjmë përmes parashtrësës apo në fjalën përfundimtare.* Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor me datë 16.09.2020 dhe fjalës përfundimtare të palëve, gjykata me datën 30.09.2020 ka nxjerr Aktgjykim nën shenjen C. nr. 5/15 me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, ashtu që duke e detyruar të paditurin e parë dhe të dytë që paditësit nën përgjegjësinë e ndarë të ia bëjnë kompenzimin e dëmit material dhe jo material në shumën e përgjithshme prej 10.410 Euro, ndërsa për pjesën tjetër të kërkesëpadisë përtej shumës së gjykuar është refuzuar pjesërisht si e pabazuar, dhe janë detyruar i padituri i parë dhe i padituri i dytë që paditësit në emër të shpenzimeve të procedurës të ia paguajnë shumën prej 980,00 €, të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit ligjor.

Në afatin ligjor kundër atij aktgjykimi kanë paraqitur ankesë të dy të paditurit.

Gjykata e Apelit me datën 14.12.2021 ka nxjerr Aktvendim me nr. Ac.5345/2020 me të cilin ka aprovuar ankesën e të paditurit duke e anuluar aktgjykimin e lartëcekur të datës 30.09.2020 dhe lënda është kthyer në rigjykim dhe rivendosje pranë gjykatës së shkallës së parë e regjistruar nën shenjen C.nr.116/21. Me vërejtjet që: *aktgjykimi i goditur nuk përmban arsye mbi faktet vendimtare dhe ato arsye janë të pamjaftueshme, pastaj ka kundërthënie mes të dispozitivit dhe arsyeve të dhëna, të cilat janë në kundërshtim me përmbajtjen e provave në shkresat e lëndës. Në aktgjykim gjykata e shkallës së parë nuk e ka vlerësuar drejtë ekspertizën e ekspertit të mbrojtjes në punë të datës 26.02.2020 nga eksperti A.K i cili ka konstatuar përgjegjësi primare të të paditurit të dytë për ndodhjen e aksidentit me datën 14.04.2014 dhe se paditësi ka vetëm përgjegjësi sekondare, andaj nuk kuptohet se mbi çfarë baze gjykatë e shkallës së parë ka vlerësuar dhe ka vendosur sipas përgjegjësisë së ndarë me përqindjen 50% me 50%. Poashtu, gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar se çfarë sigurimi ofron e paditura e parë për sigurimin e paditësit si punëtor i të paditurit të dytë, e për të kuptuar drejtë se sa bie përgjegjësia e kompenzimit të dëmit për të paditurin e parë si kompani siguroese. Gjykata e shkallës së parë e ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale edhe*

*sa i përket kërkesës kryesore të paditësit por edhe sa i përket kërkesës aksesore të tij që kanë të bëjnë me kamatë vonesën ligjore duke zbatuar nenin 177 të LMD të ish RSFJ-së e që ky nen nuk i referohet kësaj kamate në këtë nen por në Nenin 277 e i cili nen dhe ligj nuk është i zbatueshëm ndaj paditësit por që është i zbatueshëm Ligji për Marrëdhënjet e Detyrimeve të Republikës së Kosovës e vitit 2012 sepse ngjarja ka ndodhur me datën 14.04.2014.*

### **Ri-procedura:**

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas vërejtjeve të lartëcekura të Gjykatës së Apelit, e ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor me datën 12.03.2024. Në këtë seancë, kanë prezentuar përfaqësuesja me autorizim e paditësit L.P, përfaqësuesi me autorizim i të paditurit të parë F.K, dhe përfaqësuesi me autorizim i të paditurit të dytë B.A.

### **Pretendimet e palëve:**

**Përfaqësuesi me autorizim i paditësit L.P** gjatë shqyrtimit kryesor të rigjykimit ka mbet pranë parashtrësave dhe pretendimeve të mëparshme ndërsa në fjalën përfundimtare ka theksuar se: *është vërtetuar në mënyrë të pakontestueshme kërkesëpapia dhe precizimi i saj se paditësi është lënduar në vendin e punës dhe për këtë nuk mban asnjë përgjegjësi në bazë të ekspertizës së datës 06.03.2022 nga eksperti i mbrojtjes në punë R.G duke theksuar se lëshimet janë në tërësi nga ana e punëdhënësit-të paditurës së dytë sepse sipas Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetit në Punë 04/L-161 punëdhënësi obligohet që të sigurojë kushte në punë të sigurta në vendin e punës dhe të gjitha këto kushte që sigurojnë siguri për punëmarrësin në bazë të këtij ligji ka qenë i obliguar që të i sigurojë punëdhënësit në mënyrë që të mbrohet jeta dhe shëndeti i punëmarrësit. E paditura e dytë gjatë gjithë kohës nuk ka disponuar dokumentacionin e nevojshëm teknik për vlerësimin e rrezikshmërisë në vendin e punës por nuk ka poseduar udhëzimet për manipulimin dhe mirëmbajtjen e makinës i cili dokument ka qenë i domosdoshëm për të kryer punën për të cilën ka qenë i angazhuar paditësi, dhe që ky obligim ligjor bazohet në Nenin 5 pika 3 dhe nenin 6 pika 1 të Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetit në Punë 04/L-161. Lëshimet e të paditurit të dytë janë bërë edhe me rastin e angazhimit në punë të paditësit në këtë vend të punës sepse pasi që ka ndodhur aksidenti në të cilën paditësi ka pësuar lëndime të rënda trupore duke rrezikuar edhe humbjen e jetës, punëmarrësi-i padituri i dytë nuk e ka lajmëruar inspektorin e punës edhe pse në bazë të Nenit 23 pika 1 të ligjit të lartëcekur i padituri i dytë ka qenë i obliguar që menjëherë pas ndodhjes së aksidentit të lajmërojë inspektoratin e punës. Ndërsa ekspertiza e ekspertit të mëhershëm A.K për mbrojtje në punë nuk ka qenë reale, dhe se përcaktimin i përgjegjësisë sekondare të paditësi nga ana e këtij eksperti nuk ka bazë ligjore dhe nuk mbështetet në asnjë provë materiale sepse paditësi në mungesë të trajnimit dhe shkollimit nuk ka qenë në gjendje të ketë njohuri për ligjin e lartëcekur dhe se i njëjti nuk ka qenë i autorizuar në bazë të kontratës së punës që të kontrollojë makinën në aspektin teknik sepse i padituri i dytë ka pasur të angazhuar të punësuar të tjerë që janë marrë me kontrollime teknike, ashtu që gjykata e apelit e ka kthyer në rivendosje për shkak se gjykata e shkallës së parë ia ka fal besimin kësaj ekspertize të ekspertit A.K. Bazuar në këtë në seancën e rigjykimit me datën 12.05.2022 kemi propozuar që për këtë çështje të caktohet një ekspert tjetër nga fusha e sigurisë në punës ku gjykata e ka aprovuar propozimin. Me datën 03.06.2022 nga gjykata e kemi pranuar ekspertizën e ekspertit të mbrojtjes në punës R.G ku i njëjti e ka hartuar ekspertizën në mënyrë profesionale dhe pas shqyrtimit të të gjitha shkresave dhe ligjeve në fuqi ka ardhur në konstatimin se paditësi për lëndime të tij në punë nuk mban përgjegjësi, dhe në seancën e datës 24.01.2020 është bërë ekzaminimi i dokumentacionit mjekësor dhe janë dëgjuar në këtë seancë ekspertët Dr. S.D-ortoped/traumtalog dhe dr. G.H-ekspert i psikiatrisë. Kanë theksuar se gjykata duhet të i kushtojë rëndësi shëmtimit trupor i cili do të jetë i përjetshëm në të njëjtën kohë sikurse zvogëlimi i aktivitetit jetësor, dhe se eksperti Dr. S.D ka konstatuar se paditësi ka pësuar lëndime të rënda trupore. Ndërsa eksperti psikiatër ka sqaruar se në aspektin psikiatrik dëshmohet se kemi të bëjmë me lëndime të rënda trupore të paditësit të cilat i kanë shkaktuar frikë primare dhe frikë sekondarë si pasojë e aksidentit*

*në punë do ta humb jetën. Sa i përket të paditurit të parë e njejt nuk e ka bërë kompenzimin e dëmit siç parashihet në kontratë në shumën prej 800 Euro, duke ofruar kompenzim vetëm 621,80 Euro. Ndërsa e paditura e dytë në tërësi i ka ikur përgjegjësisë për kujdesin e punëtorit pas aksidentit duke mos u interesuar fare për gjendjen e tij shëndetësore dhe financiare. Baza ligjore sipas përfaqësueses së paditësit është Nenet 136, 137, 140, 154, 173, 174, 175, 176, 177, 179, 183, 190 dhe 191 të LMD-së, dhe Nenet 341, 342 dhe 357 par. 1 të LMD-së, si dhe Ligji i Punës dhe Ligji për Sigurinë dhe Shëndetit në Punë 04/L-161. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumën prej 2192,63 Euro dhe për taksë në padi shumën prej 125 Euro, për ekspertizë ortopedike shumën prej 100 Euro, ekspertizë psikiatrike shumën prej 100 Euro, ekspertizë të mbrojtjes në punë të dy ekspertëve A.K shumën prej 150 Euro dhe R.G shumën prej 200 Euro të gjitha në shumën prej 675 Euro.*

**Përfaqësuesi me autorizim i të paditurit të parë, F.K** gjatë shqyrtimit kryesor të rigjyqimit ka mbetë pranë parashtresave dhe pretendimeve të mëparshme ndërsa në fjalën përfundimtare ka theksuar se: *mbesim pranë ofertës së dhënë ndërsapjesa tjetër e kërkesëpadisë dhe lartësia e saj janë të gjitha kontestuese. Kanë ofruar shumën maksimale që mbulohet në bazë të policës së sigurimit dhe kushteve të përgjithshme pra objekt i mbulimit është Sigurimi nga aksidentet personale me maksimum për shpenzimet e mjekimit është shuma prej 800 Euro. Dhe se, sipas kontratës së sigurimit asnjë kategori tjetër dëmi nuk mund të kompenzohet nëse nuk është kontraktuar që lënë të kuptohet se shpenzimet e shërimit mund të kompenzohen për të cilën ofertë është pajtuar pala paditëse përmes të autorizuarit të tij mirëpo ka kërkuar shpenzimet e procedurës si dhe kamatën e që në rastin konkret e paditura e parë nuk i ka dhënë shkas fare për padi.*

**Përfaqësuesi me autorizim i të paditurit të dytë, B.A** gjatë shqyrtimit kryesor të rigjyqimit ka mbetë pranë parashtresave dhe pretendimeve të mëparshme ndërsa në fjalën përfundimtare ka theksuar se: *padia dhe kërkesëpadia e paditësit sa i përket të paditurës së parë është e parashkruar, sepse pretendimi i paditësit ka ndodh rasti me datën 04.01.2014 e që paditësi me datën 08.01.2015 paraqet padi por që në të përfshin vetëm të paditurën e parë, dhe pas mbajtjes së seancës së parë gjyqësore mes paditësit dhe të paditurit të parë me datën 06.12.2019 pas kësaj seance paditësi përmes parashtresës së datës 16.12.2019 bën zgjerim të padisë ashtu që si palë të paditur e fut edhe të paditurën e dytë, duke theksuar se **kërkesëpadia e paditësit është parashkruar edhe në pikëpamje objektive në kuptim të Nenit 357 dhe 368 të LMD-së sepse është paraqitur pas 3 viteve (Afati subjektiv), përkatësisht pas 5 viteve (Afati Objektiv). Të njëjtin pretendim e ka paraqitur edhe në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datën 12.05.2022.***

## **Gjendja faktike dhe Provat e administruara:**

### **Gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor në ri-procedurë në procedurën e provave ka administruar dhe lexuar provat:**

- **Kontrata e punës ne mes A... sh.p.k dhe paditësit F.H e dt.03.01.2014**, Raporti mjekësor ordianca psikiatrike "R..." nga dr. neuropsikiater dr.F.D me nr. portokolit... i dt.06.01.2015 në emër të paditësit, fl.lëshim nga Banja e Kllokotit në emër të paditësit për trajtim nga dt.07.05. 2014 gjer me dt.15.05.2014, Vendim i komisionit të shkallës së dytë e të paditurit KS "S..." për refuzimin e ankesës së paditësit e dt. 05.12.2014, **fl.lëshim nga QKUK-Klinika e Ortopedisë dhe traumatologjisë me nr. 30 për trajtimin mjekësor të paditesit nga dt.06.01.2014 gjer me dt. 15.01.2014**, tri fl.pagesa nga QKMF të dt. 03.05.2014, 10.02.12014 dhe 24.02.2014, Udhëzim per konsulltim me nr... -nuk shifet data, Raport për konsulltim me nr... i dt.10.02.2014 për paditësin, Raport nga konsullta me nr... i dt. 20.01.2014 në emër të paditësit, Udhëzim për konsulltim me nr... i dt.20.01.2014, Raport nga konsullta me nr... i dt.27.01.2014, Udhëzim per konsulltim me nr... i dt. 21.01.2014, Raport nga konsullta me nr... i dt. 24.02.2014, Udhëzim për konsulltim nga QKUK Prishtinë i dt. 21.02.2014 me nr..., Udhëzim i mjekut specialist me nr... i dt.03.03.2014 prej dy faqeve, Raport nga konsullta me nr... i dt.31.03.2014, Raport nga konsullta me nr... i dt. 27.02.2014, Raport nga konsullta me nr... i dt.03.03.2014, Udhëzim për konsulltim i dt. 03.03.2014 me nr..., Udhëzim për konsulltim me

*nr... i dt. 21.02.2014, Udhëzim për konsulltim i dt.06.02.2014 nr..., dy fl.pagesa –dëftesa i dt.03.03.2014, Fatura nr... i dt.10.01.2014 lëshuar nga O... Pejë, dy fl.pagesa–dëftesa i dt.15.01.2014, një faqe prej 6 kupona fiskal të fotokopjuara të dt.15.01.2014, 06.01.2014, 06.01.2014, 14.01.2014, 15.01.2014, dhe 14.01.2014, një faqe prej 6 kupona fiskal të fotokopjuara të dt. 13.01.2014 (4 kupona fiskal të njëjtës dt. i dt.19.01.2014 dhe 20.01.2014, një faqe prej tri kupona fiskal të fotokopjuara në të të dt. 11.01.2014, 13.01.2014, dhe 20.01.2014, **39 kupona fiskal në 8 faqe të muajit Janar, Shkurt, Mars dhe Maj - 2014, kupon fiskal i datës 03.08.2014 në shumën prej 240 euro, tri dëftesë pagesa të datës 19.05.2014, 16.06.2014 dhe 20.01.2014, Polisë sigurimi nga KS”S...” me dt. 10.shtator 2013 – i siguruari F.H, parashtrësë për precizim të kërkesëpadisë i dt. 16.12.2019, Ekspertizë nga eksperti A.K lidhur me shkaqet e lëndimit e dt. 26.shkurt 2020, Aktgjykim nën shenjën C. nr. 515 i dt.16.09.2020 i lëshuar nga Gj.Th.P-Dega në Glllogoc, Ankesë e të paditurit të dytë i dt. 15.10.2020, Ankesë e të paditurit të parë i dt. 21.10.2020, Aktvendim i Gj.Apelit i dt. 14.12.2021 - AC.nr. 5345/2020, Ekspertizë e ekspertit për mbrojtjen në punë R.G e dt. 03.06.2022, Faturë e lëshuar nga eksperti R.G e dt. 03.06.2022 në shumën prej 200 euro, Procesverbalet e seancave të dt: 06.12.2019, 24.01.2020, 23.07.2020, 12.05.2022 si dhe Mendimi dhe deklarimi i eksperteve të dhënë në seancën gjyqesore me dt. 24.01.2020, si dhe të gjitha procesverbalet e mbajtura lidhur me këtë çështje të cilat gjinden në shkresat e lëndës.***

Pas përfundimit të shqyrtimit kryesor duke vlerësuar provat e administruara veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga Neni 8 i LPK-së, gjykata ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar ndërsa pjesërisht është e pabazuar, andaj e mori këtë aktgjykim dhe vendosi si në dispozitiv për arsye faktike dhe ligjore si në vijim.

**Në mes të palëve ndërgjyqjese ishte kontestuese ishte baza e kërkesëpadisë meqë të autorizuarit e të paditurve në tërësi e kanë kontestuar kërkesëpadinë dhe lartësinë e saj, ndërsa përfaqësuesi me autorizim i të paditurit të dytë A... SHPK B.A ka paraqitur edhe pretendimin materialo-juridik të parashkrimit objektiv të kërkesëpadisë në kuptim të Nenit 357 të LMD-së.**

Në procedurë të rigjykitimit, për ta vërtetuar bazën e padisë dhe kërkesën e saj, me propozimin e palëve ndërgjyqjese gjykata në procedurën e rigjykitimit me propozim të përfaqësuesit me autorizim të paditësit me datën 17.05.2022 përmes aktvendimit ka vendosur që të nxjerret edhe njëherë prova me anë të ekspertit të mbrojtjes në punë dhe për ekspertë ka caktuar ekspertin tjetër R.G i cili është detyruar nga Gjykata që të konstatoj gjendjen reale dhe faktike duke përgatitur ekspertizën me shkrim se me lëshimet e kujt ka ardhur deri te aksidenti në punë.

Eksperti për siguri dhe mbrojtje në punë R.G i cili në bazë të dokumentacionit të prezantuar nga ana e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Glllogoc, shënimeve të marrura dhe fotografive të bëra me rastin e vizitës në vendin e ndodhjes së aksidentit (incidentit) si dhe informatave të marrura në kompaninë sh.p.k “A...” në Prishtinë, me dt. 25.02.2020 ka përpiluar Ekspertizën me përshkrimet të dhëna ka konstatuar se: *e paditura e parë mban përgjegjësi primare sepse nuk i ka përmbushë detyrat nga Neni 5 par. 2, Neni 7 par. 1.11 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4; Neni 9 par. 1, Neni 14 par. 3, Neni 16 par. 1 dhe par. 5 Neni 20 par. 1 pikat 1.1,1.2, 1.3, 1.4 dhe 1.5, Neni 21 dhe 22 par. 1 dhe Neni 23 par. 1 të Ligjit nr. 04/L-161 të Ligjit për Siguri dhe Shëndet në Punë, ndërsa paditësi për lëndimin e tij me lëshimet e tij sekondare nuk mban përgjegjësi për shkak i padituri i dytë nuk ka përmbushur detyrimet nga dispozitat ligjore të lartëcekura.*

Pasi që ishte kontestuese edhe lartësia e kërkesëpadisë për të vërtetuar lartësinë e kërkesë padisë, gjykata ka caktuar ekspertët ligjorë me propozimin e palëve ndërgjyqjese, ekspertët Dr. S.D Ortopet-traumatolog dhe Dr. G.H Neuropsikiatër.

Eksperti i Ortopedisë Dr. S.D dhe Eksperti i psikiatrisë të cilët në bazë të dokumentacionit mjekësorë dhe pas ekzaminimit të drejt për drejt të paditësit kanë dhënë mendimin profesional përmes ekspertizës ku sipas tyre paditësi ka pasur lëndime ku: *lëndimi i tillë kualifikohet si rëndim*

*i rëndë truporë, si pasoj e këtij lëndimi truporë paditësi ka pësuar: Dhimbje fizike trupore, Zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm jetësorë: Shëmtimi truporë; Nevoja për kujdesje nga personi ndihmës; Ushqimi i përforcuar, Terapi fizikale dhe rehabilitim klimatik.*

Ndërsa eksperti mjekësorë nga lëmi i psikiatrisë Dr. G.H i cili pas shikimit të dokumentacionit mjekësorë dhe intervistomi të paditësit ka dhënë këtë mendim se: *paditësi bazuar në ekzaminimin e drejt për drejt të paditësit dokumentacionin regjistruar në shkresat e lëndës, të dhënat anamnestike, sa i përket lëndimit në punë, sa i përket përjetimit eksperti psikiatër ka dhënë këtë mendim: se ka përjetuar Frika primare dhe Frika sekondare e intensitetit të mesëm dhe Frikë sekondare e intensitetit të ulët.*

Meqenëse i gjithë dokumentacioni mjekësorë që gjendet në shkresat e lëndës është vlerësuar nga ekspertët përkatës dhe të njëjtat janë pjesë e ekspertizës së dhënë gjykata nuk e ka të arsyeshme që të bëjë vlerësimin e secilës provë veç e veç.

**Prova:** Polisa e sigurimit nr... sipas kësaj prove - Periudha e sigurimit sipas është prej datës 10.09.2013 gjer me datën 29.04.2014 ndërsa rasti i siguruar ka ndodhur brenda kësaj periudhë të kontraktuar e që për shpenzimet për mjekim është shuma maksimale 800 Euro.

### **Ligji material i zbatuar**

Për përgjegjësinë juridiko-civile të dëmshpërblimit në mënyrë kumulative duhet të ekzistoj: *veprimi i kundërligjshëm, dëmi, fajësia dhe përgjegjësia si dhe lidhja kauzale në mes të veprimit dhe shkaktimit të dëmit.*

Neni 136 i LMD-së përcakton se *“kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”.*

Neni 137 i LMD-së përcakton se *“Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm), dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material).*

Neni 140 i LMD-së përcakton se *“fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”.*

Neni 179 par. 1 i LMD-së përcakton se *“Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paafëtisë për punë gjatë kohës së mjekimit”.* Me dispozitat e Nenit 183 par. 1 të LMD-së janë parashikuar llojet apo format e shpërblimit të dëmit dhe atë për dhimbjet e pësuar fizike, frikën e pësuar etj. Ky nen përcakton se *“Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material”.*

Neni 918 përcakton se *“Me kontratën për sigurimin detyrohet kontraktuesi i sigurimit që mbi parimet e reciprocitetit dhe solidaritetit të paguajë një shumë të caktuar shoqërisë së sigurimit (siguruesi), kurse shoqëria detyrohet që, nëse ndodh ngjarja që paraqet rastin e siguruar, t'i paguajë siguruesit apo ndonjë personi të tretë shpërblimin, përkatësisht shumën e kontraktuar ose të kryejë diçka tjetër”.*

Neni 922 par. 1 përcakton se “Kontrata për sigurimin është e lidhur kur kontraktuesit nënshkruajnë polisën e sigurimit ose listën e mbulesës”.

Neni 923 par. 1 përcakton se “Në policë duhet të shkruhen palët kontraktuese, sendi i siguruar, respektivisht personi i siguruar, rreziku i përfshirë nga sigurimi, kohëzgjatja e sigurimit dhe periudha e depozitës, **shuma e sigurimit** ose se sigurimi është i pakufizuar, premia ose kontributi, data e dhënies së policës dhe nënshkrimet e palëve kontraktuese”.

Neni 940 par. 1 dhe 2 përcakton se 1. Kur paraqitet rasti i siguruar, siguruksi ka për detyrë të paguajë shpërblimin ose shumën e caktuar me kontratë në afatin e kontraktuar, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se katërmëdhjetë (14) ditë, duke llogaritur që nga data kur siguruksi të ketë marrë njoftimin se ka ndodhur rasti i siguruar. 2. Mirëpo, në qoftë se për caktimin e ekzistimit të detyrimit të siguruksit ose të shumës së tij nevojitet një kohë, ky afat fillon të rrjedhë nga dita kur është vërtetuar ekzistimi i detyrimit të tij dhe shuma e tij”.

### **Vlerësimi përfundimtar i gjykatës:**

Gjykata vlerëson se në bazë të provave dhe dispozitave ligjore të lartëcekura gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, dhe në këtë gjendje faktike e ka zbatuar ligjin material si në dispozitat ligjore të mëposhtme për të gjitha format e fajit si ato aprovuese poashtu edhe ato të refuzuara.

Nga provat e administruara në këtë çështje rezulton se i padituri i parë është përgjegjës dhe fajtor për kompensimin e dëmit material për shpenzime të mjekimit e gjykuar paditësit si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Nga të lartëcekurat dhe duke marr parasysh rrethanat e rastit konkret gjykata konstatoj se paditësi F.H, si pasojë e lëndimeve të rënda trupore ka pasur shpenzime mjekësore e të cilat gjykata duke u bazuar në Polisën e Sigurimit të lidhur mes të paditurit të parë dhe të paditurit të dytë për benefit të paditësit gjeti se nga lëndimet në punë me dt. 04.01.2014 paditësi për shkak të lëndimit në punë ka pasur shpenzime mjekësore të shërimit e që janë provuar me faturat e shpenzimeve të listuara më lartë e që janë: *Fatura nr... i dt.10.01.2014 lëshuar nga O... Pejë, dy fl.pagesa-dëftesa i dt.15.01.2014, një faqe prej 6 kupona fiskal të fotokopjuara të dt.15.01.2014, 06.01.2014, 06.01.2014, 14.01.2014, 15.01.2014, dhe 14.01.2014, një faqe prej 6 kupona fiskal të fotokopjuara të dt. 13.01.2014 (4 kupona fiskal të njëjtës dt. i dt.19.01.2014 dhe 20.01.2014, një faqe prej tri kupona fiskal të fotokopjuara në të të dt. 11.01.2014, 13.01.2014, dhe 20.01.2014, 39 kupona fiskal në 8 faqe të muajit Janar, Shkurt, Mars dhe Maj - 2014, kupon fiskal i datës 03.08.2014 në shumën prej 240 euro, tri dëftesë pagesa të datës 19.05.2014, 16.06.2014 dhe 20.01.2014, e që sipas polisës së sigurimit rezulton se shuma më e lartë e kompensimit të të siguruarit për shpenzime mjekësore është shuma 800 Euro, ku si pasojë e lëndimeve të rënda trupore të pësuar nga paditësit në punë me dt. 04.01.2014 paditësi ka pasur shpenzime mjekësore e të njëjtit i takon e drejta e kompensimit material ashtu si pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Përkatësisht, me rastin e vendosjes për kërkesën për kompensimin e dëmit material si dhe lidhur me shumën e kompensimit të këtij dëmi në mes tjerash gjykata të njëjtat i aprovoj nga se gjeti se paditësi në trajtimin e tij mjekësor ka pasur shpenzime si dhe i ka afuar prova specifike lidhur me këto shpenzime.*

Duke u bazuar në këtë gjendje faktike gjykata ka vendosur si pikën I të këtij aktgjykimi për kompensimin e dëmit material të paditësit vetëm në raport me detyrimin kontraktual të të paditurit të parë ndaj paditësit për shkak të detyrimit kontraktual nga Polisa e Sigurimit, si dhe duke u bazuar në Nenin 323 të LPK-së lidhur me Nenin 136 par. 1 të LMD-së i Republikës së Kosovës i aplikueshëm, e cili i përcakton se “Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”, dhe lidhur me Nenet 2 paragrafi 1 dhe 10 të

Ligjit për Sigurinë në Punë dhe ligji Nr. 2003/19 për Mbrojtjen e shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës, i shpallur me rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/33, i cili ka qenë në fuqi në kohën e lëndimit të paditësit). Poashtu, ka vendosur edhe në kuptim të Nenit 179 par. 1 i LMD-së që përcakton se *“Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit”*. Këtë duke u bazuar edhe në dispozitat ligjore të referuara më lartë të Neneve 918, 922 pra. 1, 923 par. 1, Neni 933 dhe Neni 940 par. 1 dhe 2 të LMD-së.

Në lidhje me kërkesën e paditësit për kompenzim të dëmit material në emër të shëmtimit truporë dhe në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përhershëm jetësor prej 5 % një gjë e tillë nuk është parashtruar në mënyrë specifike as në fjalën përfundimtare të datës 20.03.2024 dhe as në precizimin e kërkesëpadisë të datës 16.12.2019 andaj gjykata nuk është lëshuar në vlerësim edhe të këtyre llojeve të dëmit jo material.

Meqenëse gjykata ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit në raport me të paditurin e parë për shkak të parashkrimit (vjetërsimit) të kërkesëpadisë të paraqitur pas 5 vjet e 11 muaj e 12 ditë pas ngjarjes së datës 04.01.2014, gjykata nuk është lëshuar në atë se a ia ka falur në tërësi besimin ekspertizave në fjalë, kjo edhe për shkak se për pikën I të dispozitivit është vendosur në bazë të Nenit 136, 137, 140 dhe 179 të LMD-së si dhe në bazë të Kontratës së Sigurimit-përkatësisht Polisës së Sigurimit e që kjo polisë e ka mbështetjen ligjore në dispozitat e Neneve 918, 922 par. 1, 923 par. 1 dhe Neni 940 par. 1 dhe 2, ndërsa rasti i siguruar përkatësisht lëndimi trupor është konstatuar edhe me ekspertizën dhe mendimin e ekspertit të ortopedisë Dr. S.D, e që rrjedh se rasti i siguruar nga polisa e sigurimit ka ndodhur pamëdyshje e që këtë obligim të pagesës së këtij dëmi material për shpenzime mjekësore të mjekimit të paditësit është vetëm shuma e gjykuar prej 800 Euro.

Në lidhje e kërkesëpadinë e refuzuar në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi përtej shumës së gjykuar nga pika I e dispozitivit të këtij aktgjykimi gjykata e ka vendosur në kuptim të Nenit 357 të LMD-së për shkak se kërkesëpadia e paditësit në drejtim të paditurit të dytë është paraqitur jashtë afatit subjektiv prej 3 viteve dhe jashtë afatit objektiv të parashkrimit prej 5 viteve, ku nga provat në shkresat e lëndës rezulton se padia nga paditësi është paraqitur në 12 janar 2015 ndaj të paditurit të parë për ngjarjen e ndodhur një vit më herët me 04.01.2014 ndërsa është zgjeruar ndaj të paditurit të dytë me datën 16.12.2019 e që i bie se është paraqitur pas 5 vjetëve dhe 11 muaj ndaj të paditurit të dytë (data 04.01.2014 dhe data 16.12.2019). Sipas Nenit 357 par. 1 dhe 2 përcaktojnë se *“1. Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dijeni për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin. 2. Në çdo rast kjo kërkesë parashkruhet për pesë (5) vite nga shkaktimi i dëmit. Përkatësisht, gjykata vendosi si në pikën II të këtij aktgjykimi ku pas vlerësimit të të gjitha provave të administruara dhe fakteve të vërtetuara gjykatës i rezultojë se kërkesë padia e paditësit F.H, përtej shumës së aprovuar e në shumë të refuzuar prej 24.200 00 € është kërkesë e pa bazur në ligj sepse është parashkruar.*

Në lidhje me kamatën ligjore që duhen të paguajë i padituri i parë për shumën e aprovuar për dëmin material (pika I), gjykata ka vlerësuar se e njëjta vlen për pagesë nga data e marrjes së këtij aktgjykimi e që në rastin konkret është 05.04.2024 duke u bazuar në Nenin 382 par. 1 të LMD-së, dhe në pajtim edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës për Kamatën e datës 02.12.2022 pika XV dhe arsyetimit të saj, se për dëmin material kamata fillon të rrjedh nga dita e ngritjes së padisë (në rastin konkret e paraqitur me datën 12.01.2015) e deri në pagesën definitive, pavarësisht se kur ka lindur marrëdhënia e detyrimit.

Për pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore gjykata vendosi konform Neni 452 par. 2 të LPK-së si dhe në bazë të TOA-së, duke ia njohur paditësit shpenzimet e kërkuara sipas suksesit në procedurë e në të cilën janë përfshirë shuma e



përgjithshme prej 2867,63 Euro, dhe atë: 208 euro për padi, për precizim të padisë shumë prej 208 Euro të datës 16.12.2019; për tre seanca të shqyrtimit gjyqësorë të para rigjykimit (C.nr. 5/15) në shumë prej 270,40 Euro secila, seanca e datës 24.01.2020 që ka zgjatur dy orë në lartësinë prej 30 % të orës së parë në shumë prej 72,21 Euro, për dy seancat në shqyrtimin e dytë pas rigjykimit prej dy seanca secila nga 270,40 Euro dhe seanca e datës 12.02.2022 që ka zgjatur dy orë në lartësinë prej 30 % të orës së parë në shumë prej 72,21 Euro, si dhe seanca e datës 12.03.2024 në shumë prej 270,40 Euro, dhe ankesën kundër aktgjykimit e në shumë e përgjithshme prej 2182,82 Euro, ndërsa për taksën në padi shumë prej 125 Euro, për ekspertiza për dy ekspertë mjekësorë-ortoped dhe psikiatër në shumë prej 200 € (nga 100 Euro secili), për ekspertizën për ekspertin per siguri dhe mbrojtjes në punë për ekspertin A.K shumë prej 150 €, për ekspertizën për ekspertin per siguri dhe mbrojtjes në punë për ekspertin R.G shumë prej 200 € e në shumë të përgjithshme prej 675 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimit e nën kërcënimin të përmbarimit ligjor.

Lidhur me pjesën e refuzuar në pikën III të dispozitivit gjykata e ka refuzuar në kuptim të Nenit 449 par. 1 dhe 452 par. 2 të LPK-së sepse për shkak të lëndimit trupor në punë të paditësit kjo i ka dhënë shkas padisë së zgjeruar të paditësit ndaj të paditurit të dytë.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të administruara në shqyrtimin kryesorë, ku erdhi në përfundim te të njëjtit janë pa ndikim për vendosjen ndryshe në mënyrë meritore në këtë çështje juridike kontestimore.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet tjera të palëve ndërgjyqëse por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Nga të cekurat më lartë gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA NË GLLOGOC**  
**Departamenti i Përgjithshëm, C.nr. 116/21 dt. 05.04.2024**

**Sekretare Juridike**

Fatmire Mehmeti

**G j y q t a r i**

**Astrit Gashi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar Ankesa në afatin prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj Gjykate.